



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr. 310/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit nr. 04/L-042, për Prokurim Publik të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe në mbështetje të nenit 53, të Ligjit me nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative në përbërje prej : z. Blerim Dina Kryetar, duke vendosur sipas ankesës parashtruar nga OE “Andident” kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Buli-Medical” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore” me nr. prokurimi 636-19-3407-236 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik, me datën: 05.08.2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Andident” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore” me nr. prokurimi 636-19-3407-236 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik.

**II. ANULOHET**, Vendimi i AK-së Komuna Junikut - Njoftimi për dhënie të kontratës i lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe servisimi i paisjeve mjeksore” me nr. prokurimi 636-19-3407-236 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Junik .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik OE “Andident”, refuzohet si e pa bazuar ankuesit i bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë: 23.05.2019

Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike kuotim, shërbime

Vlera e parashikuar e kontratës: 2,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52) tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 29.05.2019

Data e hapjes së ofertave: 29.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave: 05.06.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm: 05.06.2019

Data e njoftimit për dhënien e kontratës: 05.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim: 08.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 10.06.2019

Operatori ekonomik ankues “Andident”, me datën 13.06.2019 me nr. prot: 310/19 si palë e pa kënaqura, ka deponuar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me materiale të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit: 632-19-1137-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, duke pretenduar se janë shkelur këto dispozita të LPP-së:

- Neni 6 i LPP-së (Ekonomiciteti dhe efikasiteti)
- Neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim-Jo/diskriminimi)
- Neni 51 i LPP-së (Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes)
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 60 i LPP-së (Kriteret për dhënien e kontratave)
- Neni 72 i LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)
- Neni 108/A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve)

- Neni 43 – Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues teknik në raportin e dt: 21.06.2019

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur nenin 6 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve ka rekomanduar për kontrate OE ekonomik ne kundërshtim me paragrafin 1 te nenit 6 te LPP-se dhe po ashtu ne jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar si OE ne mënyrë te barabarte me ç rast komuna e Junikut ka bere shkelje te paragrafit 1 te nenit 7 te LPP-se, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve të dhëna në DT dhe në këtë rast ka bërë eliminimin e ofertës së OE ankues me arsyetimin se nuk e ka përmbushur një kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Në rastin kur oferta vlerësohet e pa përgjegjshëm dhe e njëjta eliminohet si e tillë, atëherë nuk kemi shkelje të nenit 6. Shkelja do të ishte nëse oferta është vlerësuar si e përgjegjshme dhe të njëjtës nuk i jepet kontrata. Po ashtu kur oferta e OE ankues është vlerësuar e pa përgjegjshme dhe ajo e rekomanduara për kontratë e përgjegjshme, atëherë nuk kemi shkelje edhe të nenit 7. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me tjetrin pretendim të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 51 paragrafi 1 të LPP-së sepse nuk ka përzgjedhë operatorin ekonomik duke u bazuar në kriteret e caktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit edhe në njoftimin për kontratë janë paraparë kriteret e përzgjedhjes sipas nenit 51 të LPP-së. Përzgjedhja e operatorëve ekonomik gjatë vlerësimit të ofertave është bërë në përputhje me këto kriteret.

OE ankues është eliminuar si i pa përgjegjshëm për shkak të mos plotësimi të një kriteri të përzgjedhjes të dhënë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Nga kjo shihet se nuk ka pasur shkelje të nenit 51 të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur pretendimin vijues të OE ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të lartë se oferta e jonë dhe AK duhet të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm në bazë të nenit 59 sidomos paragrafit 2 dhe 4, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

E theksuam edhe më lartë që eliminimi i OE ankues është bërë për shkak të mos plotësimi të një kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Kjo kërkesë ka qenë:

- Certifikata e serviserit, ndërsa Evidenca "1 Certifikatë e serviserëve të autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve laboratorike"

OE ekonomik ankues nuk ka ofruar me dokumentet e dorëzuara në platformën elektronike certifikate të serviserit të autorizuar nga prodhuesi për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike siç është kërkuar. Mirëpo ka ofruar një shkorsë se punëtori Kadri Ilazi ka ndjekur një trajnim kompanisë "Bolue" për shërbime të hematologjisë.

Ky dokument nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit sepse nuk është certifikate e serviserit të autorizuar prej prodhuesit. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi se serviseri është i certifikuar nga kompania "Bolue". Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë me ofertën e tij ka dorëzuar edhe Autorizimin që ka prej prodhuesit "Boule". Pra me këto dokumente OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar kërkesën e dosje së tenderit dhe nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues ka respektuar nenin 59 të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin tjetër, se AK nuk ka respektuar nenin 60 dhe 72 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE me çmim më të lartë dhe nuk ka kërkuar sqarime shtesë për dokumentet e dorëzuar nga OE ankues, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Është rekomanduar për kontratë OE i vetëm që ka dorëzuar ofertën e përgjegjshme, ndërsa OE ankues ka qenë i pa përgjegjshme sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e DT dhe njoftimit për kontratë që e përmendëm më lartë. Nuk ka pasur shkeljet të nenit 60 të LPP-së në këtë rast. Po ashtu AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë në bazë të nenit 72 sepse nuk ka pasur pa qartësi rreth dokumentit të ofruar nga

OE ankues. Neni 72 shumë qartë e precizon se AK mundet të kërkoj sqarime shitesë kur ai e sheh të nevojshëm, mirëpo nuk është detyruese për AK të kërkoj sqarime shitesë kur nuk ka pa qartësi. Prandaj nuk ka shkelje të nenit 72 të LPP-së dhe si i tillë edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor të OE për shkelje të nenit 108/A të LPP-së nga ana e autoritetit kontraktues sepse në përgjigjeje të kërkesës për Rishqyrtim AK nuk ka lëshuar vendim por vetëm një njoftim për OE ankues se i refuzohet kërkesa për rishqyrtim, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Si rregulle në nenin 108/A të LPP-së parashihet që AK duhet të nxjerrë vendim si përgjigjeje në kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues. Në këtë rast AK nuk e ka bërë këtë vendim por ka dhënë vetëm njoftim me shkrim. Pra OE ankues ka të drejtë. Mirëpo ky veprim i AK nuk dëmton procesin e prokurimit dhe as OE ankues sepse përgjigjeje është refuzuese për OE ankues. Pra edhe po të ishte vendim e njëjta situatë do të ishte. Thjeshtë është një lëshim procedural i AK pa asnjë ndikim në proces. Me rëndësi është që OE ankues e ka marrë përgjigjeje e autoritetit kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim dhe OE ankues ka realizuar të drejtën për ankesë në OSHP. Ky pretendim ankimor vlerësohet pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde vërehet qartë se autoriteti kontraktues në përgjithësi ka respektuar nenin 59 të LPP-së gjatë procesi të vlerësimi, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave. Në këtë proces ka pasur disa dobësi procedurale të AK të cilat nuk kanë ndikuar në procesin e prokurimit. Ato dobësi kanë qenë si, mos njoftimi i OE ankues për arsyet e eliminimit përmes formularit të rregullt standarde të KRPP-së dhe me rastin e përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim, që nuk është nxjerrë vendim por i është bërë vetëm njoftimi me shkrim i OE ankues. Të gjitha këto devijime të vogëla të AK-së të cilat lejohen edhe me nenin 59 të LPP-së pika 4, nuk kanë ndikuar në vendimin final të AK për të nxjerrë një vendim meritore për dhënie të kontratës. OE ankues është eliminuar me të drejtë si tenderues i pa përgjegjshme sepse nuk e ka plotësuar një kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Në bazë të sqarimet e dhënë më lartë lidhur me përgjigjeje në pretendimet ankimore të OE ankues, eksperti shqyrtues e vlerëson në përgjithësi ankesën si të pa bazuar dhe i rekomandon panelit shqyrtues ta Refuzoj atë.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdoj me dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve mjekësorë" me nr. prokurimi 636-19-3407-236 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Operatori Ekonomik ankues OE "N.T."Agimi-DE", Prishtinë përmes parashtresës me shkrim me dt. 25.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim me dt. 21.06.2019 nuk ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet apo jo me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.08.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesit e OE-së ankues, ndërsa përfaqësuesit e AK-së nuk marrin pjesë në këtë seancë, të njëjtit kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës dëgjimore dhe njëkohësisht na kanë njoftuar me anë të parashtresës se për arsye teknike nuk mund të marrin pjesë në seancën, poashtu na kanë njoftuar se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues lidhur me vlerësimin e kësaj lëndë. Poashtu edhe eksperti shqyrtues mungon në këtë seancë i njëjti na ka njoftuar me anë të parashtresës se gjendet në pushim vjetor i njëjti na ka njoftuar se mbetet mbrapa raportit të dhënë në Ekspertizës. Seanca vazhdoj me palët prezentë ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së OE-së z. Bala deklaroj: Ne OE "Andident" nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues sepse ekspertin shqyrtues nuk ka bërë vlerësim të Ankesës tone të plote ku nuk është marrë parasysh pretendimi tone.

Ne jemi eliminuar nga Autoritet Kontraktues në kriter kapacitetet teknike dhe profesionale ku në Dosjen Tenderi ka qenë kriteri të Kapacitetet teknike dhe profesionale Kërkesa 1 ka qenë Certifikate e Serviserit ne si OE kemi dorëzuar Certifikate e serviserit i cilin është i licencuar nga kompanie BOLUE për servisimin e pajisjeve laboratorik të kompanisë BOLUE që prodhon pasjet në këtë.

Kurse eksperti shqyrtues gjatë vlerësimit ka arritur në përfundim se stafi jonë nuk është i Diplomuar apo certifikuar nga prodhuesi, por eksperti shqyrtues nuk ka bërë vlerësim adekuat dhe profesionale sepse në vlerësimin e tij eksperti shqyrtues ka konstatuar se punëtori jonë Kadri Ilazi ka ndjekur një trajnim kompanisë BOLUE për shërbime të hematologjisë por ne nuk pajtohemi me vlerësimin e ekspertit sepse Certifikata e Serviserit tone ose Diplomën e punëtori tonë Kadri Ilazi e dorëzuar në këtë tender dhe ne

Ankesën tone thotë citim “Boule Medical vërteton se Kadri Ilazi ka marrë pjesë në trajnimin për Shitje dhe Servisim të pajisjeve tona hematologjike si psh servisim ne këto fusha si Servisim për Kontroll dhe kalibrim, Elektronik, Rregullim etj”.

Kurse eksperti shqyrtues fjale Service nga Anglisht në Certifikata e ka përkthyer në shqip vetëm si shërbime kurse fjale Service ka shume kuptim në Shqip si psh Servisim dhe Shërbime pra punëtori jone është i certifikuar për servisim e pajisjeve hematologjike pra termi hematologjike përfshin pajisjet e laboratorit.

Edhe ky tender pra KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË –është për SHËRBIM, pra termin Service e ka shume kuptim si Servisim dhe Shërbimet.

Ne besoj se paneli te merr parasysh sqarimin tone edhe te korrigjon raportin ekspertin lidhur me këtë pike. Ju lutem shikon Diplomën e Kadri Ilazit te dorëzuar në këtë tender PROVA 1 Gjithashtu ne besoj se AK ka mundur te shfrytëzoj te drejt ligjore te kërkoj informacion shtesë nga ne sipas Nenit 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë për çdo sqarim apo informacion shtesë për sqarim të çdo dokumenti e jo te na eliminoj drejt për drejt.

Gjithashtu Eksperti shqyrtues nuk e ka shqyrtuar fare ne Ankesën tone Piken 43 Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve e Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik ku Autoritete Kontraktues ka qenë i obliguar që tenderuesi te informohet me Letrat Standarde përkatëse me arsyetimet e nevojshme siç është paraparë pike 43, por këtë Autoritete Kontraktues nuk e ka bere publike pra ne nuk kemi Letrën Standarde për Tenderues të eliminuar as ne e-prokurim e as ne e-mail kurse pyetje ime për Ekspertin shqyrtues. Ku e ka marr Letrën Standarde për Tenderues të eliminuar sepse ne raportin tij thotë se Letra standarde është me datën 05.06.2019 ju lutem shikon ne e-prokurim a ka letër Standarde për Tenderues të eliminuar. Ju lutem shikoni Njoftim e Autoritet Kontraktues te datës 05.06.2019 pa Letrën Standarde për Tenderues PROVA 2 Letrën Standarde për Tenderues të eliminuar pra ka vetëm vendim te Autoritet Kontraktues pra raporti i ekspertin shqyrtues se ka bere një raport jo ne fakte dhe argumente relevante pra mos publikim i Letrën Standarde për Tenderues të eliminuar është shkelje e LPP. Paneli duhet te këtë parasysh se Autoritete Kontraktues ka bere shkelje te LPP si neni 6,7,59 dhe piken 43 Rregullave dhe Udhëzuesi Operative te prokurimit. Panelit i dorëzojmë provat materiale te cilat janë: 1. Diplome, certifikate, prova për letrën standarde.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te aprovon ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues teknik , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka shkelur:

-nenin 6 dhe 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve ka rekomanduar për kontrate OE ekonomik ne kundërshtim me paragrafin 1 te nenit 6 te LPP-se dhe po ashtu ne jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar si OE ne mënyrë te barabarte me ç ‘rast komuna e Junikut ka bere shkelje te paragrafit 1 te nenit 7 te LPP-se.

- nenit 51 paragrafi 1 të LPP-së sepse nuk ka përzgjedhë operatorin ekonomik duke u bazuar në kriteret e caktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

- të nenit 59 të LPP-së sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të lartë se oferta e jonë dhe AK duhet të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm në bazë të nenit 59 sidomos paragrafit 2 dhe 4.

Paneli shqyrtues konstaton se eliminimi i OE ankues sipas Autoritetit Kontraktues është bërë për shkak të mos plotësimit të një kërkesë të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Kjo kërkesë ka qenë:

III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
	<b>Kërkesa 1 Certifikate e serverëve.</b>	<b>Evidenca 1 Qertifikata e servisereve të autorizuar nga prodhuesi për mirmbajtjen e ktyre paisjeve laborotorike.</b>

Operatori ekonomik ankues ka ofruar Diplome ku vërteton se ka certifikuar Z. Kadri Ilazin i cili e ka ndjekur një trajnim kompanisë “Bolue” dhe AK nëse ka dilema konform nenit 72 mund te kërkoj sqarime shtese lidhur me këtë diplomë pasi qe vet kërkesa e AK-se nuk e saktëson se çfarë certifikate por vetëm certifikate te serviserit, Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues është eliminuar pa te drejte nga ana e AK-se.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 7, 59 dhe 72 të LPP-së. Obligohet AK ne te ardhmen ti përmbahet te gjitha dispozitave te LPP-se dhe gjithashtu ti respektoj te gjitha dispozitat e RrUOPP-se.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK Komuna e Junik

1x1 OE "Andident"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

